

Nr 4 Prot

Nr 1577 Prot

16.11.2020

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

**NDËRMJET:**

**KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
përfaqësuar nga Komisioneri, **Z. Robert GAJDA**

**DHE**

**INSTITUTIT SHQIPTAR PËR ÇËSHTJET PUBLIKE (AIPA)**  
përfaqësuar nga Drejtore Ekzekutive, **Znj. Eurona LEKA**,  
rregjistruar me vendimin nr. 665, datë 23.03.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me seli në  
rrugën e Kosovarëve nr.37, me NIPT L11618451F.

**Tiranë, 16 Nëntor 2020**

**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe “INSTITUTI SHQIPTAR PËR ÇËSHTJET PUBLIKE ”, më poshtë të quajtura “palë”,**

Referuar eksperiencës dhe përvojës së gjatë në garantimin e zbatimit dhe realizimit të misioneve të përbashkëta në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në mbështetje të Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Nisur nga dëshira për të vendosur lidhje institucionale bashkëpunimi në interes të të dyja palëve, me qëllim promovimin e arsimit të lartë, kërkimit shkencor, rritjen e kapaciteteve të personelit akademik dhe studentëve.

Bashkëpunimin e ndërsjellë në realizimin e veprimtarisë në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, ranë dakord për sa vijon:

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe Objekti**

Në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshje, palët bien dakord të bashkëpunojnë në çdo kohë dhe ta shtrijnë këtë bashkëpunim në të gjitha fushat e veprimtarisë së tyre dhe për të cilat shfaqin interes të përbashkët.

### **NENI 2**

#### **PARIME TË PËRGJITHSHME**

Kjo marrëveshje lidhet për të lehtësuar marrëdhëniet ndërinstitucionale për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të palëve, me synim komunikimin dhe shkëmbimin e personelit akademik, informacioneve, ideve dhe eksperiencave që lidhen me fushat me interes të përbashkët, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Kjo marrëveshje shërben si bazë bashkëpunimi dhe nuk krijon të drejta ose detyrime ligjore. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë marrëveshje nuk çenojnë apo ndikojnë tek të drejtat dhe detyrimet që i burojnë këtyre palëve nga kontrata/marrëveshje të tjera, apo nga legjislacioni në fuqi.

## Neni 4

### Të drejtat dhe detyrimet e partnerëve

1. *Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:*
  - a. KMD do të kërkojë ekspertizë në fushën që institucioni partner mbulon, në përputhje me kërkesat dhe kriteret për një ekspertizë të caktuar;
  - b. KMD do të kontribuojë në nxitjen dhe promovimin e institucionit partner përmes marrëdhënies së partneritetit në nivele të tjerë të fushës së lobimit dhe advokacisë;
  - c. KMD do të punojë së bashku me partnerët përmes nismave të përbashkëta, duke ngritur grupe pune;
2. *AIPA – Instituti Shqiptar për Çështjet Publike:*
  - a. AIPA angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojë kontribut KMD, me kërkesën e tij, duke vënë në dispozicion specialistët e tij më të mirë;
  - b. AIPA angazhohet të mbështesë KMD në kuadër të hartimit e zhvillimit të politikave e platformave që të mundësojnë ndërveprimin midis aktorëve të ndryshëm;
  - c. AIPA shpreh vullnetin për të bashkëpunuar e sjellë rezultate pozitive në drejtim të partneritetit dhe realizimit të objektivave , brenda fushës së përgjegjësive të KMD duke punuar për realizimin e përsosjen e marrëdhënieve midis palëve;
  - d. AIPA angazhohet se do të marrë në aktivitetet e takimet, mbi fushat e përbashkëta, ku do të jetë i ftuar nga KMD;
3. *Palët bashkarisht bien dakort si vijon:*
  - a. të punojnë së bashku në drejtim të hartimit të thirrjeve për projekte sipas përcaktimeve, të objektit të partnerit privat dhe fushës së përgjegjësive të KMD;
  - b. të jenë në kontakt për çdo thirrje të mundshme dhe mundësi bashkëpunimi në partneritet;
  - c. të zbatojnë programet dhe projektet e përbashkëta me interes publik si dhe shkëmbimin e informacionit e dokumentacionit, i cili do të përdoret vetëm për qëllime të realizimit të projekteve;
  - d. të bashkëpunojnë në çdo fushë tjetër të pa listuar më sipër, brenda objektit të tyre dhe për të cilët palët kanë kapacitetet e përshtatshme profesionale.

## NENI 4

### FORMAT DHE MËNYRAT E BASHKËPUNIMIT

1. Bashkëpunimi midis palëve do të realizohet me anë të aktiviteteve të përbashkëta, shkëmbimit të informacionit dhe botime akademike apo periodike, shkëmbimit të personelit akademik

2. Kërkesa për informacion, shkëmbim apo zhvillim të aktiviteteve të përbashkëta do t'i drejtohet palës tjetër me shkrim dhe në gjuhën shqipe.
3. Kërkesa për bashkëpunim duhet të sigurojë një përshkrim të përgjithshëm lidhur me qëllimin për të cilin kërkohet bashkëpunimi dhe kohën e dëshiruar për konkretizimin e bashkëpunimit.
4. Pala së cilës i drejtohet kërkesa, pasi e analizon atë, i siguron palës tjetër informacionin që ai zotëron. Në rast se kërkesa nuk mund të pranohet, pala së cilës i drejtohet kërkesa duhet t'i japë përgjigjen me shkrim palës që kërkon informacionin, në lidhje me shkaqet që e pengojnë dhënien e informacionit.

## NENI 5

### KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

1. Palët për zbatimin e kësaj marrëveshjeje caktojnë nga një person kontakti/koordinator për secilin institucion.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në vazhdimësi, në varësi të nevojës për bashkëpunim.
3. Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e të dy institucioneve në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

## NENI 6

### DISPOZITA TË FUNDIT

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.
2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim.

## NENI 7

### HYRJA NË FUQI

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe është e vlefshme për një periudhë 1 (një) vjeçare.
2. Ajo rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur për vitet pasardhëse, në rast se palët nuk shprehen me shkrim për të kundërtën.
3. Mosrinovimi i kësaj marrëveshjeje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga pala e interesuar të paktën 3 muaj përpara përfundimit të saj.

Pasi u lexua, u gjend e rregullt dhe konformë vullnetit të të dyja palëve, marrëveshja nënshkruhet nga secila palë.

Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe, në dy kopje origjinale, një për secilën palë.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**



**DREJTORI EKZEKUTIV**

**Eurona LEKA**

